

**VENDIMI I ORTAKUT TË VETËM TË SHOQËRISË ME PERGJEGJËSI TË  
KUFIZUAR  
“URBAN RETREAT” Sh.p.k**

Sot, më 17/01/2024 në Tirane, palët si më poshtë :

Julian Rebi, lindur në Gjirokastër, më 15 Tetor 1991 me shtetësi dhe kombësi shqipëtar, banues në Tirane në adresën Rruga Njesia Bashkiake Nr.2, Rruga “Mihal Grameno, Pallati 12, Shk.4, Ap.1, Tirane, me numër ID J11015092F do të zoterojë 1 (një) kuotë të barabartë me 100.000 Lekë që përfaqëson 100% (njëqind për qind) të kapitalit të shoqërisë;

madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, me vullnetin e tij të lirë e të plotë, nëpërmjet këtij akti përcakton Administratorin e shoqërisë “Urban Retreat” Sh.p.k, sipas legjisacionit shqiptar në fuqi dhe kushteve të parashikuara më poshtë.

Rendi i dites:

Caktimi i administratorit të shoqërisë “Urban Retreat” Sh.p.k.

Ortaku i Vetëm VENDOSI:

Administratori i Shoqërisë do të jetë Julian Rebi, lindur në Gjirokastër, më 15 Tetor 1991 me shtetësi dhe kombësi shqiptare, banues në Tirane në adresën Njesia Bashkiake Nr.2, Rruga “Mihal Grameno, Pallati 12, Shk.4, Ap.1, Tirane, me numër ID J11015092F.

Kohëzgjatja e qëndrimit në detyrë të Administratorit është për një afat 5 (pesë) vjeçar, me të drejtë ripërtëritje të këtij mandati.

Shkarkimi dhe ndryshimi i administratorit do të kryhet në përputhje me parashikimet në Statutin e Shoqërisë.

**ORTAKU THEMELUES**

Julian REBI



**STATUTI  
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
"URBAN RETREAT" SHPK**

EMERTIMI-OBJEKTI-QENDRA-KOHEZGJATJA

**NENI 1-Emërtimi i shoqërisë**

Shtetasi shqipëtar,:;

Julian Rebi, i biri i Spiros, lindur në Gjirokaster, më 15 Tetor 1991 me shtetësi dhe kombësi shqiptare, banues në Tirane në adresën Njesia Bashkiake Nr.2, Rruga "Mihal Grameno, Pallati 12, Shk.4, Ap.1, Tirane, me numër ID J11015092F, është ortak i vetëm i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar e quajtur, "Urban Retreat" sh.p.k.

Shoqëria është person juridik dhe do ushtrojë veprimtarinë në bazë të ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 «Për tregtaret dhe Shoqëritë tregtare» i ndryshuar.

**NENI 2—Objekti i veprimtarisë së shoqërisë**

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do jete si vijon:

- Marrje dhe dhënie me qera ambjente banimi për qëndrim të përkohshëm.

**NENI 3-Kohëzgjatjae veprimtarisë**

Shoqëria do te ushtrojë aktivitetin tregtar do jetë subjekt i të drejtës shqiptare pa afat të përcaktuar.

Me vendim te ortakut të vetëm afati i mësipërm mund te ndryshojë ose shoqëria mund të shkrihet.

**NENI 4-Vula**

Shoqëria do të ketë vulën e vet në formën e përcaktuar nga ortaku.

**NENI 5 -Selia e shoqërisë**

Shoqëria "Urban Retreat" Sh.p.k ka qendrën në Tiranë ne adresën Rr "Mine Peza", Ndertesa Nr.200, Apartamenti Nr.22, dhe do te ketë të drejtë të ushtrojë aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Shoqëria mund të krijojë agjenci, zyra përfaqësimi, qendra dytësore në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.



## NENI 6- Kapitali i regjistruar

Kapitali i shoqërisë është LEKE 100.000 (Njeqindemijë lekë) dhe është kapital i ortakut të vetëm.

Kapitali është i ndare në 1 kuote me vlerë 100.000 lekë (Njeqindemijë lekë).

Kapitali i shoqërisë mund te rritet apo zvogëlohet me vendim të ortakut të vetëm.

## NENI 7-Transferimi i kuotave

Kuotat e kapitalit janë lirisht të transferueshme.

1.Kuotat e kapitalit të shoqërisë si dhe të drejtat qe rrjedhin prej tyre me vendim të ortakut të vetëm mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit ne kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- c) dhurimit; (si personave që kanë lidhje gjaku me ortakun e vetëm ashtu edhe të tjerëve pa lidhje gjaku)
- d) çdo mënyre tjetër te parashikuar me ligj.

2. Ne rastin e kalimit te kuotave me kontrate, kontrata duhet te behet me shkrim.

## NENI 8—Ortaku i vetëm

Shoqëria zotërohet nga një ortak dhe të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga ortaku i vetëm. Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënët e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen.

Duhen regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurisë se veprimtarisë;
- Shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- Investimet e reja;
- Vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme.

Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria vendos ndryshe.

## NENI 9 –Drejtimi dhe administrimi

9.1 Shoqëria tregtare "Urban Retreat" sh.p.k do drejtohet nga një administrator që emërohet me vendim të ortakut të vetëm.

Administrator i Shoqërisë duke filluar nga data e sotme për pesë vitet në vazhdim (17/01/2024 deri 16/01/2029) do të jetë ortaku i vetëm Julian Rebi.

9.2 Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga ortaku i vetëm;
- përfaqëson shoqërinë tregtare;
- kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara ortakut të vetëm për miratim;
- krijon një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- kryen regjistrimet dhe dërgojnë të dhënrat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- raporton përpara ortakut të vetëm në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësitë veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

9.3 Ortaku i vetëm mund ta shkarkojë administratorin në çdo kohë. Statuti apo marrëveshje të tjera nuk mund ta përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë.

Paditë, që lidhen me shpérblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

9.4. Administratori do shpërblehet sipas përcaktimit të ortakut të vetëm në përputhje me parashikimin e nenit 97 te ligjt nr.9901 date 14.04.2008.

9.5 Administratori ka të drejtë të caktojë dhe revokojë persona të tretë ne mungesë dhe për llogari të tij.

#### NENI 10-Kontrolli i brendshëm

Shoqëria tregtare organizon kontrollin e brendshëm me një kontabël të miratuar, i cili është përgjegjës përpara kësaj shoqërie për dëmet që mund të shkaktojë nga moskryerja në rregull e detyrës së tij.

#### NENI 11—Bilanci dhe të ardhurat

Veprimet ekonomike e financiare të shoqërisë mbyllen më 31 dhjetor të çdo viti përveç rasteve e urdhrave të veçanta të ortakut të vetëm të saj. Në fund të çdo periudhe ushtrimore nxirret bilanci kontabël me rezultatin ekonomik HUMBJE FITIME.

Bilanci kontabël miratohet brenda datës 31 mars të vitit pasardhës dhe pas përcaktimit të detyrimeve fiskale pjesa që mbetet i jepet për përdorim Ortakut të vetëm të saj.

## NENI 12—Shpërbërja e shoqërisë

Shpërbërja e shoqërisë mund të vijë në çdo kohë dhe për çfarëdo shkak. Në rast shkrirje të shoqërisë, Ortaku i vetëm vendos mbi mënyrat e likuidimit dhe cakton një ose më shume likuidatorë duke iu përcaktuar edhe detyrat.

Në rastin e likuidimit emërtimi i shoqërisë do të shoqërohet nga shënim:

### **SHOQERI NE LIKUIDIM E SIPER.**

Administratori regjistron prishjen e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

## NENI 13 - Dispozita përfundimtare

Për sa nuk është shprehur plotësisht në këtë statut do i referohet plotësimeve të bëra nga ORTAKU I VETEM.

Shoqëria "Urban Retreat" Sh.p.k do të jetë subjekt i të drejtës shqiptare dhe do ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje me normat e legjisacionit shqiptar në përgjithësi dhe normat e këtij statuti.

Ky statut nënshkruhet prej ortakut në datë 17/01/2024.

**ORTAKU I VETEM**

Julian REBI

